

Banka e Shqipërisë

**METODIKA E KOMPILIMIT
TË MJETEVE TË REZERVËS
NDËRKOMBËTARE**

DEPARTAMENTI I STATISTIKAVE FINANCIARE

SHTATOR 2016

PËRMBAJTJA

A.	STATISTIKAT E MODULIT TË REZERVËS NDËRKOMBËTARE DHE LIKUIDITETIT NË VALUTË	4
1.	<i>Përkufizime</i>	4
1.1	<i>Koncepte</i>	4
1.2	<i>Institucionet e mbuluara</i>	5
1.3	<i>Aktivitetet financiare të mbuluara</i>	5
2.	<i>Regjistrimi</i>	5
B.	HARTIMI I REZERVËS NDËRKOMBËTARE DHE LIKUIDITETIT NË VALUTË	7
1.	<i>Burimet e të dhënave</i>	7
C.	PARAQITJA E REZERVËS NDËRKOMBËTARE DHE LIKUIDITETIT NË VALUTË	8
1.	<i>Struktura e modulit</i>	8
1.1	<i>Mjetet e rezervës zyrtare dhe mjete të tjera në valutë</i>	8
1.2	<i>Tërheqje të parapërcaktuara afatshkurtra neto të mjeteve në valutë</i>	8
1.3	<i>Tërheqjet të kushtëzuara afatshkurtra të burimeve në valutë</i>	9
1.4	<i>Zërat memo</i>	9
D.	ANEKS	10
1.	<i>Tabela analitike e modulit të rezervës ndërkombëtare dhe likuiditetit në valutë</i>	10

A. STATISTIKAT E MODULIT TË REZERVËS NDËRKOMBËTARE DHE LIKUIDITETIT NË VALUTË

Statistikat e Rezervës Ndërkombëtare dhe Likuiditetit në Valutë (RNLV) janë kompiluar në përputhje me standardet ndërkombëtare, të përshkruara në "Manualin e Statistikave të Bilancit të Pagesave dhe Pozicionit të Investimeve Ndërkombëtare, Edicioni i Gjashtë" (FMN, 2009) dhe në "Guidën e Rezervës Ndërkombëtare dhe Likuiditetit në Valutë" (FMN, 2013). Ndjekja e këtyre standardeve siguron pajtueshmëri të të dhënave nga njëra anë dhe nga ana tjetër, konsistencë midis statistikave të mjeteve RNLV e atyre të Borxhit të Jashtëm Bruto, Bilancit të Pagesave dhe Pozicionit të Investimeve Ndërkombëtare. Të dhënat mbi MRNLV-të janë një burim i rëndësishëm informacioni për zëra të caktuar të statistikave më sipër.

Të dhënat e paraqitura në këtë modul (aneksi bashkëlidhur) i përkasin: (i) stokut të fundit të periudhës të mjeteve të rezervës zyrtare dhe të pretendimeve në monedhë të huaj të Bankës dhe qeverisë qendrore, (ii) flukseve të paracaktuara dhe (iii) të kushtëzuara afatshkurtra neto të mjeteve në valutë dhe (iv) zërave Memo. Të dhënat janë kompiluar në bazë bruto: d.m.th ato përfshijnë detyrimet e lidhura me rezervën për tabelat 2 dhe 3 të modulit. Si e tillë, tabelat e RNLV-së identifikojnë ato elemente që tregojnë pretendimet financiare në stok dhe pretendimet dhe detyrimet financiare në fluks të Bankës dhe qeverisë qendrore të Shqipërisë në valutë. Shifrat prezantohen në formate të pranuar ndërkombëtarisht për të pasur krahasueshmëri mes vendeve. Informacioni raportohet me frekuencë mujore tek Fondi Monetar Ndërkombëtar <http://www.imf.org/external/index.htm>.

1. PËRKUFIZIME

1.1 KONCEPTE

Moduli i të dhënave për rezervën ndërkombëtare dhe likuiditetin në valutë bazohet në dy koncepte kryesore të lidhura me njëra-tjetrën: (1) rezerva ndërkombëtare, dhe (2) likuiditeti në valutë.

Rezerva ndërkombëtare e një vendi përkufizohet si: "Ato mjete të huaja, të cilat janë menjëherë të disponueshme dhe të kontrolluara nga autoriteti monetar për financimin e drejtpërdrejtë të zhbancimit të pagesave, për rregullimin indirekt të këtyre zhbancimeve nëpërmjet ndërhyrjes në tregjet valutore për të ndikuar kursin e këmbimit dhe/ose për qëllime të tjera". Koncepti i rezervës ndërkombëtare nuk përfshin detyrimet e huaja të autoriteteve monetare. Mjetet financiare që zakonisht përfshihen në këtë kategori, janë monedhat dhe kartëmonedhat në valutë, depozitat në valutë në bankat jorezidente, letrat me vlerë të emetuara nga jorezidentët, ari monetar, mbajtjet e SDR-së, pozicioni rezervë në FMN dhe mjete të tjera financiare.

Koncepti i likuiditetit në valutë është më i gjerë se ai i rezervës ndërkombëtare dhe i referohet (1) burimeve në valutë, dhe (2) tërheqjeve neto nga burimet e rezervës, qofshin këto të njohura paraprakisht (skeduluara) apo të kushtëzuara nga ndodhja e ngjarjeve të caktuara. Këto tërheqje neto rrjedhin nga detyrimet afatshkurtra të autoriteteve monetare dhe nga aktivitetet e tyre të regjistruara jashtë bilancit.

E thënë ndryshe, pozicioni i likuiditetit në valutë të autoriteteve i referohet burimeve të valutës së huaj, që janë lehtësisht të disponueshme nga autoritetet, duke marrë parasysh tërheqjet neto të paracaktuara dhe potenciale nga këto burime.

1.2 INSTITUCIONET E MBULUARA

Ky modul aplikohet për të gjitha njësitë e sektorit publik përgjegjëse për administrimin e krizave të monedhës. Praktikisht këtu përfshihen autoritetet monetare, të cilat administrojnë apo mbajnë rezervat ndërkombëtare dhe qeveria qendrore, e cila së bashku me autoritetet monetare mbajnë dhe pjesën më të madhe të detyrimeve financiare zyrtare në valutë. Në Shqipëri, ky modul përfshin Bankën e Shqipërisë dhe qeverinë.

1.3 AKTIVITETET FINANCIARE TË MBULUARA

Në këtë modul përfshihen vetëm instrumentet e emetuara dhe të pagueshme në valutë. Mjetet e huaja në monedha të pakonvertueshme, si edhe të gjitha mjetet që nuk plotësojnë kriteret e përkufizimit të mjeteve të rezervave, nuk përfshihen në modul.

2. REGJISTRIMI

Regjistrimi i stokeve dhe flukseve në MRNLV bazohet vetëm në transaksionet e autoriteteve në valutë.

Vlerësimi i mjeteve dhe detyrimeve realizohet duke u bazuar në çmimet e tregut për tabelën e parë dhe në vlerën nominale për tabelat 2 dhe 3.

Në modul, vlera e burimeve në valutë duhet të reflektojë vlerën që do të përfitohet nga likuidimi i tyre i menjëhershëm në treg, që do të thotë vlera e tregut në datën e referencës. Në rastet kur vlera e tregut e instrumenteve nuk mund të përcaktohet, standardi parashikon llogaritjen e vlerës së përafërt të tregut.

Tërheqjet nga burimet në valutë, si ato të paracaktuara, ashtu dhe ato të kushtëzuara, vlerësohen sipas vlerës së tyre nominale; që do të thotë në vlerën e flukseve të arkës kur këto flukse ndodhin.

Horizonti kohor i mbuluar nga moduli është 12 muaj pas datës së referencës. Ky horizont ndahet në disa nënperiudha për të mundësuar vlerësimin e pozicionit të likuiditetit përgjatë vitit. Këto nënperiudha janë specifikuar si “deri në një muaj”, “mbi një muaj deri në tre muaj” dhe “deri në një vit”.

Të dhënat për gjendjet iu referohen gjendjeve pezull të mjeteve dhe detyrimeve në datën e dhënë. Për flukset, të dhënat që raportohen janë flukset e ardhshme të valutës së huaj të njohura paraprakisht në datën e referencës, të cilat lidhen me pozicione të paracaktuara ose të kushtëzuara pezull në datën e referencës. Momenti i regjistrimit përfaqëson një moment të caktuar në kohë për tabelën e parë, si fundmuaji. Ky moment drejtohet nga parimi i “kontabilitetit rrjedhës”. Pretendimet dhe detyrimet lindin kur ka një ndryshim në pronësi ndërmjet rezidentëve dhe jorezidentëve, siç evidentohet nga transaksionet ku mjetet dhe detyrimet financiare krijohen, transformohen, shkëmbehen, transferohen ose asgjësohen. Për tabelën e dytë dhe të tretë, zërat e regjistruar i përkasin harkut kohor të një viti.

Monedhat e kompilimit të pozicionit ndërkombëtar të investimeve janë ALL dhe USD. Të dhënat e instrumenteve mblidhen në monedhë origjinale dhe konvertohen me kursin e fundit të periudhës për stoqet dhe me kursin mesatar të periudhës për flukset në ALL dhe USD.

B. HARTIMI I REZERVËS NDËRKOMBËTARE DHE LIKUIDITETIT NË VALUTË

Mjetet e RNLV-së kompilohen me frekuencë mujore, publikohen çdo muaj 30 ditë pas periudhës së referencës në faqen zyrtare të internetit të Bankës së Shqipërisë, në adresën “Statistika”/Seri Kohore/Statistika të Sektorit të Jashtëm/Rezerva Ndërkombëtare” dhe në adresën e SDDS-së, sipas kalendarit të publikimeve. Banka e Shqipërisë kryen rishikim e të dhënave, duke përdorur të dhënat më të fundit për të përmirësuar saktësinë e tyre. Për rishikimet, Banka e Shqipërisë publikon një dokument të shkurtër, duke shpjeguar shkakun dhe madhësinë e rishikimeve.

1. BURIMET E TË DHËNAVE

Burimet kryesore për hartimin e mjeteve të RNLV-së paraqiten në tabelën e mëposhtme:

	Burimi i të dhënave	Institucioni/ Departamenti i cili dërgon të dhënat	Frekuenca e dërgimit
MRNLVH			
Mjetet e rezervës zyrtare	Bilanci i Bankës së Shqipërisë	Banka e Shqipërisë, Departamenti i Sistemeve të Pagesave, Kontabilitetit dhe Financës	Mujore
	Rezerva operative mujore	Banka e Shqipërisë, Departamenti i Operacioneve Monetare	Mujore
	Bilanci i llogarive	Banka e Shqipërisë, Departamenti i Operacioneve Monetare	Mujore
	Bilanci i zotërimeve të portofolit dhe depozitave	Banka e Shqipërisë, Departamenti i Operacioneve Monetare	Mujore
	Pozicioni i rezervës në Fond	Fondi Monetar Ndërkombëtar, FMN	Mujore
Monedha të tjera në valutë	Raportet e autoritetit monetar	Banka e Shqipërisë, Departamenti i Sistemeve të Pagesave, Kontabilitetit dhe Financës	Mujore
Flukset e paracaktuara	Flukset e paracaktuara të bankës qendrore	Fondi Monetar Ndërkombëtar, FMN	Mujore
	Flukset e paracaktuara të qeverisë qendrore	Ministria e Financave	Mujore
Flukset e kushtëzuara	Bilanci i Bankës së Shqipërisë	Banka e Shqipërisë, Departamenti i Sistemeve të Pagesave, Kontabilitetit dhe Financës	Mujore
	Flukset e kushtëzuara të qeverisë qendrore	Ministria e Financave	Mujore
Zërat Memo ¹	Tabelat 1, 2 dhe 3, (mjetet e rezervës mujore dhe mjete të tjera në valutë, tërheqjet neto afatshkurtra të paracaktuara dhe të kushtëzuara	MRNLVH ose çdo burim shtesë që mund të jetë i nevojshëm për plotësimin e informacionit	Mujore

¹ Të dhënat për zërat Memo sigurohen nga tre tabelat e mëparshme ose nga burime të tjera shtesë, që mund të jenë të disponueshme gjatë periudhës. Ato përfaqësojnë detajime të informacionit të paraqitur në tre tabelat e para.

C. PARAQITJA E REZERVËS NDËRKOMBËTARE DHE LIKUIDITETIT NË VALUTË

1. STRUKTURA E MODULIT

Moduli i rezervës ndërkombëtare dhe likuiditetit në valutë ka katër seksione:

1.1 MJETET E REZERVËS ZYRTARE DHE MJETE TË TJERA NË VALUTË

Në pjesën A të këtij seksioni paraqiten mjetet e rezervës zyrtare sipas instrumenteve: monedhat dhe kartëmonedhat në valutë, ari monetar, SDR-ja, dhe pozicioni i rezervës në FMN.

Në pjesën B të seksionit, pasqyrohen mjete të tjera likuide në valutë (që nuk përfshihen në rezervën zyrtare). Këtu përfshihen vetëm mjetet e emetuara në monedhë të konvertueshme, të cilat mund të jenë mjete ndaj rezidentëve ose jorezidentëve. Në këtë zë të modulit raportohen mjetet e qeverisë qendrore (duke përfshirë fondet e sigurimeve shoqërore).

Burimet e informacionit dhe metodat e përpunimit:

Instrumentet në pjesën A të seksionit janë regjistruar me vlerën e tyre të tregut dhe si burim informacioni shërbejnë të dhënat nga raportimet e marra nga Departamenti i Sistemeve të Pagesave, Kontabilitetit dhe Financës si dhe ai i Operacioneve Monetare në Bankën e Shqipërisë (pasqyra e rezervës valutore operative). Si burim për të dhënat e instrumenteve të pjesës B të seksionit, shërbejnë kryesisht regjistrimet kontabël të Ministrisë së Financave. Aktualisht, Ministria e Financave nuk ka instrumente të cilat i përmbushin këto kritere.

1.2 TËRHEQJE TË PARAPËRCAKTUARA AFATSHKURTRA NETO TË MJETEVE NË VALUTË

Tërheqje të parapërcaktuara afatshkurtra neto të mjeteve në valutë janë detyrime kontraktuale të njohura paraprakisht (skeduluara) në valutë. Këto flukse iu referohen detyrimeve kontraktuale në valutë, të cilat do të ndodhin me siguri brenda 12 muajve nga data e raportimit. Ato llogariten si diferencë e flukseve dalëse me flukset hyrëse.

Burimet e informacionit dhe metodat e përpunimit:

Si burim informacioni për këtë tabelë shërbejnë skedulat e borxhit dhe pagesave të tjera të Ministrisë së Financave dhe Bankës së Shqipërisë, si dhe të dhënat mbi flukset hyrëse të lidhura me letrat me vlerë dhe depozitat në

bankat jorezidente, të marra nga Departamenti i Operacioneve Monetare në Bankën e Shqipërisë.

1.3 TËRHEQJET TË KUSHTËZUARA AFATSHKURTRA TË BURIMEVE NË VALUTË

Flukset e kushtëzuara lidhen me detyrime kontraktuale, të cilat mund të sjellin shtimin apo pakësimin e burimeve në valutë. Flukset e pasqyruara këtu mund të rrjedhin nga mjetet e detyrimet, që mund të lindin në 12 muajt e ardhshëm nga periudha e referencës. Flukset e kushtëzuara lidhen vetëm me aktivitetet jashtë bilancit dhe janë të kushtëzuara nga ndodhja e një ngjarjeje të caktuar.

1.4 ZËRAT MEMO

Nën "Zërat Memo" përfshihen informacione shtesë që mbulojnë:

- flukset dhe pozicionet e papërfshira në seksionet H-III, por të para si me rëndësi për vlerësimin e rezervave të autoritetit, vlerësimin e likuiditetit në valutë dhe ekspozimit ndaj riskut të valutës;
- të dhëna shtesë mbi flukset dhe pozicionet e dhëna në seksionet H-III; dhe pozicione e flukse sipas një shkallëzimi apo kriteri vlerësimi të ndryshëm nga ato të dhëna në seksionet H-III.

D. ANEKS

1. TABELA ANALITIKE E MODULIT TË REZERVËS NDËRKOMBËTARE DHE LIKUIDITETIT NË VALUTË

I. Mjetet e rezervës zyrtare dhe mjete të tjera në valutë		
Në milionë USD		
		Muaji
A. Mjetet e rezervës zyrtare		
(1) Rezervat në valutë (në monedhë të huaj të konvertueshme)		
(a) Letra me vlerë		
Nga të cilat: emetuesi me qendër në vendin raportues por aktivitet jashtë tij		
(b) Monedha dhe kartëmonedha dhe depozita me:		
(i) banka qendrore të huaja, BIS dhe FMN		
(ii) banka me qendër në vendin raportues		
Nga të cilat: që kryejnë aktivitet jashtë tij		
(iii) banka me qendër jashtë vendit raportues		
Nga të cilat: që kryejnë aktivitet brenda tij		
(2) Pozicioni rezervë në Fond		
(3) SDR		
(4) Ari (duke përfshirë depozitat në ar)		
Vëllimi në milionë Onc		
(5) Mjete të tjera të rezervës (specifiko)		
— Derivatë financiarë		
— Hua jorezidentëve jobanka		
— Të tjera		
B. Mjete të tjera në valutë (specifiko)		
— Letra me vlerë të papërfshira në mjetet e rezervës zyrtare		
— Depozita të papërfshira në mjetet e rezervës zyrtare		
— Hua të papërfshira në mjetet e rezervës zyrtare		
— Derivate financiare të papërfshira në mjetet e rezervës zyrtare		
— Ar i papërfshirë në mjetet e rezervës zyrtare		
— Të tjera		

II. Tërheqje të parapërcaktuara afatshkurtra neto të mjeteve në valutë (vlera nominale)				
Në milionë USD				
	Total	Muaji		
		Ndarja e maturitetit (maturiteti i mbetur)		
		-1 muaj	1-3 muaj	3 muaj -1 vit
1. Hua, letra me vlerë dhe depozita në valutë				
— flukse dalëse(-)				
Principali				
Interesi				
— flukse hyrëse(+)				
Principali				
Interesi				
2. Pozicione të gjata dhe të shkurtra në kontrata të ardhshme dhe me afat në valutë kundrejt valutës vendase				
(a) Pozicione të shkurtra (-)				
(b) Pozicione të gjata (+)				
3. Të tjera (specifiko)				
— Flukse dalëse të lidhura me repot (-)				
— Flukse hyrëse të lidhura me repot (+)				
— Kredia tregtare (-)				
— Kredia tregtare (+)				
— Llogari të tjera të pagueshme (-)				
— Llogari të tjera të pagueshme (+)				

III. Tërheqjet të kushtëzuara afatshkurtra të burimeve në valutë (vlera nominale)				
Në milionë USD				
	Total	Muaji		
		Ndarja e maturitetit (maturiteti i mbetur)		
		1 muaj	1-3 muaj	3 muaj -1 vit
1. Detyrime të kushtëzuara në valutë				
(a) Garanci të mbështetura me kolateral mbi borxhin me efekt deri në një vit				
(b) Detyrime të tjera të kushtëzuara				
2. Letra me vlerë të huaja të emetuara me opsione të lidhura me to				
3. Linja krediti të pakushtëzuara të patërhequra të ofruara nga:				
(a) banka qendrore të huaja, BIS, FMN, dhe organizata ndërkombëtare të tjera				
—Banka qendrore të huaja (+)				
—BIS (+)				
—FMN (+)				
(b) me banka dhe institucione të tjera financiare me qendër në vendin raportues (+)				
(c) me banka dhe institucione të tjera financiare me qendër jashtë vendit raportues (+)				
Linja krediti të pakushtëzuara të patërhequra të ofruara për:				
(a) banka qendrore të huaja, BIS, FMN, dhe organizata ndërkombëtare të tjera				
—Banka qendrore të huaja (-)				
—BIS (-)				
—FMN (-)				
(b) me banka dhe institucione të tjera financiare me qendër në vendin raportues (-)				
(c) me banka dhe institucione të tjera financiare me qendër jashtë vendit raportues (-)				
4. Pozicione të gjata dhe të shkurtra në opsione në valutë kundrejt valutës vendase				
(a) Pozicione të shkurtra				
(b) Pozicione të gjata				
PRO MEMORIA: In-the-money options				
(1) Në kursin e këmbimit korrent				
(a) Pozicioni i shkurtër				
(b) Pozicioni i gjatë				
(2) + 5% (zhvlerësim me 5%)				
(a) Pozicioni i shkurtër				
(b) Pozicioni i gjatë				
(3) – 5% (vlerësim me 5%)				
(a) Pozicioni i shkurtër				
(b) Pozicioni i gjatë				
(4) + 10% (zhvlerësim me 10%)				
(a) Pozicioni i shkurtër				
(b) Pozicioni i gjatë				
(5) – 10% (vlerësim me 10%)				
(a) Pozicioni i shkurtër				
(b) Pozicioni i gjatë				
(6) Të tjera (specifiko)				

IV. Zëra Memo	
Në milionë USD	
	Muaji
(1) Për t'u raportuar me frekuencën dhe afatin standard të raportimit	
(a) Borxhi afatshkurtër në valutë vendase i indeksuar me kursin e këmbimit	
(b) Instrumente financiare të emtuara në valutë dhe të pagueshme në mënyra të tjera (p.sh., në monedhë vendase)	
(c) mjete të vëna peng	
— të përfshira në mjetet e rezervës	
— të përfshira në mjetet e tjera në valutë	
(d) Letra me vlerë të dhëna hua dhe nën marrëveshje riblerjeje	
— të dhëna hua dhe nën marrëveshje riblerjeje dhe të përfshira në Seksionin I	
— të dhëna hua dhe nën marrëveshje riblerjeje dhe të papërfshira në Seksionin I	
— të marra hua dhe të përfshira në Seksionin I	
(e) derivativë financiarë	
(f) derivativë financiarë me maturitet më të gjatë se një vit	
(2) Për t'u raportuar me frekuencë më të vogël:	
(a) Përbërja e rezervës sipas monedhave (ose grupeve të monedhave)	
— monedha që përfshihen në shportën e SDR-së	
— monedha që nuk përfshihen në shportën e SDR-së	